



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 8.12.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Etem Arifi, Mexhide Mjaku – Topalli dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Basri Kastrati-Prokuroria e shtetit, Lirak Çelaj- Zëvendësministër i Drejtësisë, Alketa Spahiu UNDP-Ministria e Drejtësisë, Triumf Sadikaj- Ministria e Drejtësisë, Dalina Kërqeli-YIHR, Basri Kastrati nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Lejla Selimi- OSBE, Rinor Gashi-Handikos, Osman Shatri-Handikos, Nora Kelmendi-KDI dhe Ukë Gashi-ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nr.26;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
4. Njoftim për fushatën 16 ditëshe të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas.
Të ftuar: Lirak Çelaj, koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe Basri Kastrati, Menaxher për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Zyra e Prokurorit të Shtetit.

5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Para miratimit të rendit të ditës kryetarja e Komisionit i njoftoi anëtarët e Komisionit se Slavko Simiq është zëvendësuar me anëtarin tjetër Nenad Rashiq.

Po ashtu u vendos që takimi të fillojë me pikën e katërt për shkak të ftuarve në mbledhje të Komisionit.

4 Njoftim për fushatën 16 ditëshe të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas.

Të ftuar: Lirak Çelaj, koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe, Basri Kastrati, menaxher për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Zyra e Prokurorit të Shtetit.

Kryetarja- Pasi përshendeti të ftuarit njoftoi se Komisioni ka filluar të monitorojë Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje dhe njoftimet e tyre janë me rëndësi për Komisionin, si dhe vizitat që do t'i realizojnë në të ardhmen do të jenë të mirseardhura me qëllim të identifikimit të gjendjes aktuale të zbatimit të Ligjit në fjalë.

Lirak Çelaj – Në cilësinë e koordinatorit Nacional kundër dhunës në familje i njoftoi anëtarët e Komisionit se janë në përfundim të hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje 2016 – 2020, ku në përpërje të grupit punues janë përfshirë aktorë nga shoqëria civile dhe nga institucionet relevante në Kosovë. Ai i njoftoi se paraprakisht ata e kanë bërë rishikimin e strategjisë paraprake, e cila ka skaduar në vitin e kaluar dhe arsyeja pse ka ndodhur vonesa ka qenë vakumi institucional i vitit të kaluar që ka ndikuar në mungesën e koordinatorit Nacional për një vit dhe kjo ka ndikuar edhe te vonesa e strategjisë. Ai theksoi se nga fillimi i mandatit të tij, në bashkëpunim me organizatat mbështetëse dhe aktorët e tjerë janë dakorduar që ta bëjnë rishikimin e strategjisë së kaluar në mënyrë që të identifikohen përparësitë dhe të metat që kanë rezultuar nga ajo strategji. Kjo ka ndikuar që të merren parasysh veprimet e nevojshme që të përfshihen në strategjinë e re në mënyrë që efikasiteti të jetë sa më i madh. Lidhur me këtë rishikim ai tha se kanë përgatitur një raport në të cilën kanë paraqitur të gjeturat pozitive dhe negative, si dhe rekomandimet. Te të gjeturat pozitive ai përmendi akktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese e cila ka përcaktuar aplikimin direkt të konventave ndërkombëtare në rast se ato bijnë në kundërshtim me ligjet aktuale në Kosovë. Pas rastit të Diana Kastratit, ai the se ka reaguar edhe Këshilli Gjyqësor i cili ka kërkuar që urdhërat për mbrojtje për shkak të dhunës në

familje të jenë në pajtim me afatet e përcaktuara në Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje. Po ashtu, pas vendimit nr 22 / 2012 të gjitha Gjykatat në Kosovë kanë emëruar gjyqtarë për të prioritarizuar çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Pikë tjetër pozitive që ai përmendi ishte vetëdijësimi në implementimin e legjislacionit të dhunës në familje. Gjithashtu institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë iniciative për implementimin e kornizës ligjore të përcaktuar në strategji dhe në ligj. Lidhur me këtë ai përmendi edhe nxjerrjen e aktit nënligjor 12 / 2012, i cili përcakton masat e trajtimit psikosocial për personat e dhunës në familje. Ai i njoftoi edhe për hartimin e formularit të kërkesave për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes nga zyra për avokim. Ndërsa sa i përket anëve negative ai përmendi nivelin e kufizuar të njohjes së konventave ndërkombëtare nga gjykatësit, prokurorët dhe juristët. Masat e dhëna për urdhëra të mbrojtjes janë të arsyetuara dobët, po ashtu institucionet i kushtojnë vëmendje të dobët lëshimit të urdhërave për mbrojtje. Gjithashtu ai përmendi mungesën e raportit jo të mjaftueshëm të dhunës ndaj të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara për të cilat nevojitet statistika dhe të dhëna uniforme për identifikimin e plotë të rasteve. Lidhur me këtë ai tha se nevojiten aktivitete të mëtutjeshme për vetëdijësimin e strukturave gjyqësore për zgjerimin e njohurive për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shfrytëzimit të ligjit sipas rastit që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare. Në fund ai shtoi se nevoja e vetëdijësimit për këtë çështje është e nevojshme, përveç institucioneve edhe te qytetarët sepse në bazë të një raporti që është bërë ka rezultuar se 1/5 e popullatës e arsyeton dhunën në familje si dukuri e rëndomtë, andaj është e nevojshme që të merren hapa për vetëdijësimin e popullatës.

Kryetarja – Tha se është evidente që shifrat janë në rritje dhe ne konsiderojmë se kjo është si shenjë e vetëdijësimit dhe ishte e pajtimit se duhet të ndërmerren hapa për vetëdijësimin e kësaj çështje. Ajo, po ashtu, theksoi se fushata është realizuar në qarqe të ngushta dhe ishte e mendimit se duhet të zgjerohet në ato pika ku është identifikuar se ka nevojë të bëhet vetëdijësimi pasi që dhuna sipas saj ka kuptim mjaft të gjerë dhe mund të reflektohet në disa dimensione.

Basri Kastrati, udhëheqes i Zyrës për Mbrojtje të Viktimave, pranë Zyrës së Kryeprokurorit – Sa i përket çështjeve të dhunës në familje ai theksoi se roli i tyre është mbrojtja dhe përfaqësimi i kërkesave për urdhër mbrojtje. Sipas të dhënave që ai i prezantoi mund të konstatohet se ka një rritje të lehtë të dhunës në familje nga viti në vit duke reflektuar në këtë mënyrë ngritje të rasteve të dhunës në familje. Lidhur me këtë ai theksoi se mund të ndodhë që rritja e rasteve të jetë si shkak i vetëdijësimit të qytetarëve të cilët e lajmrojnë rastit se sa si fenomen që reflekton rritjen e dhunës në familje. Në vazhdim ai theksoi se jo të gjitha rastet e dhunës bien në domenin e tyre, mirëpo çdo rast që paraqitet në polici ata informohen qoftë me kontakt direkt apo nga raporti 24 orësh dhe atëherë zyrtarët e Zyrës së Kryeprokurorit merren me këto çështje në mënyrë të identifikimit sa më të mirë që rasteve dhe analizimit të situatës për mbështetje të rasteve të tilla.

Ai e theksoi se jo të gjitha rastet janë në domenin e tyre, sepse në raste të caktuara viktimat deklarohet se nuk i do shërbimet e zyrës së tyre dhe angazhon avokat, gjë që automatikisht këta i përjashton nga mundësia që të kenë qasje në këtë çështje. Sa i përket kërkesave për urdhër-mbrojtje vetëm në 9 mujin e parë të këtij viti ai i posedon 342 kërkesa për urdhër-mbrojtje për të cilat janë lëshuar 247 vendime të gjykatave që d.m.th. janë pranuar 247 kërkesa për urdhër-mbrojtje, 9 raste janë refuzuar, si dhe 75 raste të tjera janë tërhequr nga pala. Lidhur me rastet e tërheqjes së kërkesës për urdhër-mbrojtje do duhej të shikohet mundësia e intervenimit në legjislacion në mënyrë që secili rast apo kërkesë për urdhër-mbrojtje, pa marrë parasysh a është tërhequr apo jo të zhvillohet procedura sepse do të kishte ndikimin e vet pozitiv. Sa i përket rasteve të ndëshkimit ai theksoi se ekzistojnë tarifa të ulta të ndëshkimit për raste të tilla, gjë që do të duhej të ndryshonin në të ardhmen sepse ka shumë pak raste kur shqiptohet dënimi për personat të cilët e shkelin urdhër-mbrojtjen e lëshuar nga gjykata. Ai përmendi edhe ndryshimin pozitiv të bazës ligjore sepse ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për dallim nga rregullorja e mëhershme ka përcaktuar detyrimin e trajtimit të detyrueshëm për kryerësit e dhunës në familje. Ai theksoi se Këshilli Prokurorial i Kosovës ka caktuar 7 koordinatorë në secilën prokurori që do të jenë përgjegjës për rastet e dhunës në familje, dhe ai tha se në ditët e ardhshme do të takohen me këta koordinatorë në mënyrë të qartësisht të qëllimit dhe objektivave e mos të mbesin vetëm formale çështjet, por edhe të materializohen. Sa i përket ngritjes së aftësive profesionale të policisë dhe punëtorëve social duhet të punohet në këtë drejtim sepse ka mungesë të aftësisë profesionale në këtë drejtim, andaj do të duhet të kontribuohet në këtë drejtim. Ai i informoi Komisionin se është krijuar një linjë e veçantë qendrore për t'i mundësuar qytetarëve lajmërimin e rasteve të dhunës në familje, kjo mund të shfrytëzohet në Vala dhe Ipko dhe është konfidenciale.

Kryetarja – Në vazhdim pyeti se a kanë identifikuar se cila është hallka më e dobët e cila sjell deri te dështimi apo tërheqja e padisë siç u theksuar më heret. Po ashtu ajo pyeti se sa janë marrë ata me çështjet e trafikimit, konkretisht me çështjet e lypësisë kur dihet se kjo çështje është mjaft aktuale në Rajon, por edhe në Kosovë dhe cilat janë kategoritë më të prekura nga ky fenomen.

Lirak Qelaj – Duke u ndërlidhur me pyetje theksoi se një ndër pikat e dobta është edhe buxheti, dhe nuk kanë arritur që të sigurojnë një buxhet të qëndrueshëm, sepse këto çështje kanë një kosta mjaft të madhe dhe momentalisht është e pamundur që ata t'i mbulojnë të gjitha nevojat e domosdoshme. Po ashtu ai theksoi se me disa vendime janë mbështetur strhimoret në disa komuna edhe pse kjo çështje është identifikuar si pikë e dobët që nevojitet të veprohet në përmirësimin e gjendjes aktuale. Ai në fund theksoi se do të angazhohen që ta kenë një buxhet të përhershëm në mënyrë të përballimit të aktiviteteve të shumta që përmban në vete kjo fushë shumë e ndjeshme.

Basri Kastrai – Duke u përgjigjur në këtë pyetje theksoi se pika apo hallka më e dobët do të jetë riintegrimi afatgjatë i viktimave d.m.th. kthimi në jetë normale. Gjithashtu ai përmendi edhe ligjin e ri i cili bën kompenzimin e viktimave të dhunës në familje. Ky ligj hyn në fuqi në vitin 2016 për të cilin nevojitet krijimi i fondit në mënyrë të realizimit të kompenzimit. Lidhur me pyetjet e trafikimit të qenieve njerëzore ai tha se lypësia është e evidente edhe në Kosovë. Lidhur me këtë Drejtorati lidhur me trafikimin me qenie njerëzore kanë bërë hulumtime në vazhdimësi dhe kanë identifikuar raste ku lypësia bëhet në mënyrë familjare, e disa të tjera edhe trafikim. Sa i përket lypësve ata shumica janë nga Shqipëria dhe Kosova ka bërë një memorandum me Shqipërinë lidhur me trajtimin e këtyre rasteve në mënyrë të evitimit të këtij fenomeni negativ.

Salihe Mustafa – I njoftoi të ftuarit se Komisioni ka filluar monitorimin e ligjit kundër dhunës në familje dhe në bazë të informacioneve që të ftuarit kanë ofruar ajo tha se mund të konstatohet se Ligji ka nevojë që të plotësohet dhe ndryshohet. Ajo kishte dilema se sa janë të sakta statistikatat dhe pyeti se sa mund të jenë të sakta statistikatat lidhur me këto çështje. Po ashtu ajo pyeti se si do të veprohet me kryerësit e dhunës në familje të cilët nuk kanë nevojë të trajtohen qoftë për alkool, drogë apo diç të ngjajshme, si do të veprohet me personat që janë mentalisht në gjendje të shëndoshë. Po ashtu ajo pyeti se a kanë paraparë ndonjë aktivitet për kryerësit recidivistë të cilët në vazhdimësi mund të jenë kryerës të dhunës në familje.

Basri Kastrati – Duke u ndërlidhur me parafolësen theksoi se statistikatat që ai ka prezantuar janë statistika institucionale dhe lidhur me këtë ai theksoi se këto raste janë reale dhe të sakta duke u identifikuar me policinë, prokurorinë, etj.

Mexhide Mjaku – Topalli – Pyeti të pranishmit se cilat kanë qenë objektivat e parapara për parandalimin e fenomenit të dhunës në familje. Po ashtu ajo pyeti se për shtëpitë- ndalesa që janë nëpër qendrat e Kosovës. Ajo theksoi se në ligj shkruan se ministratë janë përgjegjëse për ndërmarrjen e të gjitha masave për krijimin e infrastrukturës ndihmëse, dhe sa do të punohet në këtë drejtim që çdo qendër të ketë këto pika, ashtu siç janë të parapara në ligj. Po ashtu në fund ajo pyeti se sa është kompetencë e tyre që ata të kenë takime në faza tre mujore me qendrat sociale në komunat e caktuara në Kosovë, duke u fokusuar se ata në vazhdimësi kanë pasur ankesa qoftë për infrastrukturë apo mungesa të tjera që i kanë penguar nëpunësit socialë të kryejnë punën e tyre në mënyrë të duhur.

Lirak Çelaj - Duke u përgjigjur theksoi se nuk është kompetencë e tyre që të kenë takime të tilla, sepse ata merren vetëm me infrastrukturën ligjore, si dhe përgatitjen e strategjisë, kurse sa i përket kësaj pyetje ai tha se janë kompetent Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Sa i përket rregullativës juridike ai theksoi se qëllimi kryesor i tyre bazohet në shtyllën e parë që ka të bëjë me parandalimin e këtij fenomeni, e pastaj do të mundohet që të merren me çështjet e tjera.

Mexhide Mjaku – Topalli – Duke u ndërlidhur me të dhënat që u ofruan nga përparësitë e strategjise që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve për të prioritarizuar çështjet e lëshimit të urdhërave të mbrojtjes për shkak të dhunës në familje, problemet ende janë evidente për arsye të ndryshme duke reflektuar në vonesat për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes.

Basri Kastrati – Tha se secila gjykatë ka caktuar nga një zëvendës në mënyrë të zëvendësimit të gjyqtarëve që shkojnë në pension apo janë në pushim me qëllim që mos të ndodhin vonesa në lëshimin e urdhërave të mbrojtjes. Kjo është bërë relativisht vonë dhe kjo pritet që në të ardhmen të mos ketë vonesa në lëshimin e urdhërave të mbrojtjes. Sa i përket prokurorive ai theksoi se secila prokurori e ka nga një prokuror të dhunës në familje dhe në plan tani është hartimi i strategjisë për dhunën në familje.

Kujtim Paqaku – Duke u ndërlidhur me numrin e paraqitur të rasteve të dhunës në familje shprehi dilema rreth saktësisë së këtij numri duke marrë parasysh traditën dhe kulturën në Kosovë që rezulton në moslajmërimin e rasteve të tilla dhe për këtë arsye numri mund të jetë ai i cekuri, por ndoshta në realitet është shumë më i madh. Ai ishte i mendimit se duhet të bëhen akoma më shumë hapa me qëllim të sensibilizimit dhe vetëdijësimit të popullatës në mënyrë që ata të vetëdijësohen sa më shumë për këtë fenomen dhe për t'u lajmëruar rastet e ndodhura. Ai po ashtu pyeti se sa lëndë janë të bartura nga vitet e kaluara, sa lëndë janë në pritje dhe sa lëndë janë ekzekutuar lidhur me dhunën në familje. Po ashtu ai pyeti se sa janë profesionalë punëtorët për rehabilitim të personave të tjerë që kanë përjetuar dhunë në familje, apo kanë qenë dëshmitarë në dhunën e familjes. Po ashtu ai pyeti se sa shkolla kanë psikologë në mënyrë që ai t'i trajtojë fëmijët që janë dëshmitarë apo viktime të dhunës në familje sepse mund të ndodhë që fëmijët të mund të marrin si shmebul dhunën në familje dhe atë ta bartin në shkollë. Sa i përket çështjes së lypësisë ai theksoi se ka pasur shumë takime me kategori të tillë dhe konstatoi se ata janë shumë të trajnuar që mos të japin informacione lidhur me të vërtetën e tyre.

Basri Kastrati – Duke u ndërlidhur me numrin e rasteve të dhunës në familje ai theksoi se nuk ka vjetërsi për urdhërat e mbrojtjes sepse afati i tyre është brenda 20 ditëve dhe ai tha se më herët e ceku se disa janë shqiptuar nga gjykata dhe disa janë tërhequr dhe refuzuar. Kurse sa i përket profesionalizmit të punëtorëve socialë ai theksoi se qendrat janë bartur nga ministria në komuna dhe ka mbetur një vakum dhe pritet që ai të eliminohet në vazhdim sepse situata aktuale ka mungesa që pritet përmirsimi i tyre. Lidhur me këtë ai theksoi se në vazhdimësi mbahen trajnime dhe duhet të mbahen trajnime në vazhdim me qëllim që personeli të jenë sa më të informuar dhe sa më profesionalë që të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Sa i përket psikologut ai tha se nuk është i sigurt, por në bazë të disa informatave psikologu është kthyer në disa shkolla që kanë numrin e nxënësve përmbi 500. Ai tha se do të jenë si mbështetës të ministrive të caktuara lidhur me këtë çështje me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Kujtim Paqaku – Theksoi se në të dhënat e ofruara nga Human Right Watch ka raportuar për 520 raste të fëmijëve romë që janë të trafikuar seksualisht dhe qëndrojnë në vende të caktuara dhe ai shprehu dilemat e tij për rastet e tilla që mund të ndodhin edhe në Kosovë.

Mexhide Mjaku – Topalli – Lidhur me deklaratimet e të ftuarit u ndërlidh me rastet e shkeljes së urdhërit të mbrojtjes. Ajo pyeti se kujt duhet t'i drejtohet viktimat në rast se është shkelur urdhëri mbrojtjes ndaj viktimës.

Basri Kastrati – Duke u ndërlidhur me pyetjen theksoi se gjykata urdhënin e lëshuar e njofton stacionin e policisë, qendrën sociale dhe mbrojtësin e viktimave dhe përcillet gjendja. Gjikata e obligon policinë, mbrojtësin e viktimave dhe qendrën sociale që të reagojnë në raste të tilla kur bëhet shkelja e urdhërit të mbrojtjes.

Kryetarja – Duke falënderuar për informacionet e dhëna dhe për prezencën e të ftuarit e mbylli këtë pikë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 26

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes nr. 26 u miratua pa vërejtje.

3 Shqyrtimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Kryetarja - I informoi të pranishmit së Projektligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është miratuar në parim nga Kuvendi dhe është ngarkuar Komisioni për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojë dhe amendametojë dhe t’ia paraqet Kuvendit Raportin me Amendamentet eventuale. Ajo përmendi hapat e nevojshëm në vazhdim duke u fokusuar te mbajtja e një dëgjimi publik, mirëpo fillimisht ajo tha se është e nevojshme dhe detyrë e Komisionit që ta formojë një grup punues lidhur me shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit në fjalë.

Pas një debati ndërmjet anëtarëve të Komisionit lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

I . Formohet Grupi Punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë me këtë përbërje:

1. Nenad Rasiq, kryesues,
2. Salihe Mustafa, anëtare,
3. Etem Arifi, anëtar.

II. Obligohet Grupi Punues që ta shqyrtojë dhe amendametojë projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe Komisionit t’ia paraqet Raportin me amendamente.

Kryetarja - Duke shfaqur mendimin e saj për nevojën e mbështetjes së Komisionit nga subjektet e tjerë, theksoi se do të jetë e nevojshme realizimi i një hulumtimi nga ekspertët e kësaj fushe lidhur me çështjet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe rregullativës juridike në shtetet e tjera lidhur me këtë fushë. Për këtë ajo kërkoi mendimin e anëtarëve të tjerë të

Komisionit se a pajtohen me propozimin për kërkesën për një hulumtim i cili do të mbështetet nga KDI-ja, si dhe angazhimi i një eksperti nga fusha e caktuar në mënyrë të ofrimit të mbështetjes në shqyrtim dhe amendamentim të projektligjit në fjalë. Sa i përket caktimit të datës për mbajtjen e Dëgjimit Publik, si dhe veprimeve të tjera lidhur me projektligjin ajo tha se këto do t'i lihen në kompetencë Grupit Punues pasi që ata janë duke u marrë me çështjet e projektligjit.

Nenad Rashiq – Duke u ndërlidhur me çështjen e hulumtimit theksoi se do të jetë shumë e nevojshme që hulumtimi të jetë profesional dhe ta tregojë pasqyrën e saktë, sepse kjo ka rëndësi shumë të madhe. Ai po ashtu kërkoi informacione për kohën e realizimit të hulumtimit në mënyrë që të ndërmrren veprimet e tjera. Ai ishte i mendimit që në vazhdim të mbahen takime me MPMS, Zyrën Ligjore të Kryeministrit, si dhe Ministrinë e Financave me qëllim të diskutimit të çështjeve që lidhen me projektligjin dhe përmbajtjen e tij.

5 Të ndryshme

Mexhide Mjaku – Topalli – Lidhur me monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga Dhuna në Familje theksoi se ajo nuk ka informacione të sakta se kush është pjesë e Grupit Punues pasi që ditën kur është formuar Grupi Punues është thënë që kushdo ka të drejtë të marrë pjesë në vizita, mirëpo përveç kryesuesit atë ditë nuk është caktuar shprehimisht ndonjë anëtar tjetër.

Kryetarja – Shfaqti dilema se nuk ka informacione se znj. Mjaku – Topalli është kryesuese e Grupit për monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje. Lidhur me vizitat e planifikuara për monitorimin e ligjit ajo tha se të gjithë subjektët që kanë qenë në plan të vizitohen me qëllim të realizimit të monitorimit të ligjit kanë qenë të zënë kohën e fundit, sepse kanë marrë pjesë në grupe punuese për hartimin e strategjisë për mbrojtje nga dhuna në familje. Ky ka qenë shkaku që kanë dështuar realizimi i disa vizitave të parapara për monitorimin e ligjit, mirëpo këto vizita do të realizohen në të ardhmen.

Mexhide Mjaku – Topalli – Kërkoi sqarime lidhur me informacionin se a është kryesuese e Grupit Punues për monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Kryetarja – Tha se do të shikohet në procesverbal dhe do të vërtetohet kjo çështje.

Nenad Rashiq – Kërkoi që më 10. 12. 2015 të mbahet një takim me MPMS dhe Zyrën Ligjore të Kryeministrit me qëllim të shqyrtimit të projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Kryetarja – I informoi Komisionin se në materialet e tyre e kanë raportin e vizitës së realizuar në Bosnë dhe Hercegovinë dhe nëse kanë pyetje konkrete mund t'i bëjnë.

Salihe Mustafa – E falënderoi kryetaren për raportin e përgaditur dhe kërkoi që kjo praktike të respektohet edhe në rastet e tjera në mënyrë që Komisioni të informohet rreth mbarëvajtjes dhe çështjeve me rëndësi që janë identifikuar gjatë realizimit të vizitave.

Kryetarja – Po ashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit se Komiteti i grave të verbëra ka kërkuar takim me Komisionin me qëllim të diskutimit për gjendjen e tyre. Ajo ishte e mendimit që në takimin e radhës të ftohen në takim në mënyrë që të realizohet kërkesa e tillë.

Po ashtu ajo e diskutoi përsëritjen e kërkesës së zvendës së Avokatit të Popullit, z. Staletoviq dhe konstatoi se përderisa çështja është në procesin gjyqësor Komisioni nuk ka të drejtë që të marrë qëndrim, sepse do të përzihet në kompetencën e gjyqësorit, andaj për këtë nuk mund të vendosë.

Nenad Rashiq – Duke u ndërlidhur me këtë çështje theksoi se është interes i të gjithëve që të shqyrtohen të gjitha çështjet që i drejtohen Komisionit. Ai theksoi se çështja e z. Staletoviq që gjindet në gjykatë, Komisioni mundet që t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë informacion zyrtar rreth zhvillimit të procedurës lidhur me këtë çështje.

Kryetarja – E ritheksoi se kjo çështje është zvarritur për shumë arsye sepse ka ndodhur në kohën kur ka ekzistuar vakumi institucional dhe pastaj gjykatat kanë qenë duke u transferuar në objektin e ri dhe për këtë arsye lënda është zvarritur, mirëpo pasi që lënda e lartpërmendur gjendet në procedura gjyqësore pritet që shumë shpejt të vendosë gjykata dhe pastaj hiqen dilemat rreth kësaj çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi